



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA  
MINISTRIA E FINANCAVE, PUNËS DHE TRANSFEREVE

**DEPARTAMENTI PËR POLITIKAT E PUNËS DHE PUNËSIMIT**  
**DIVIZIONI PËR POLITIKAT E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË**  
**PUNË**

ANALIZË MBI GJENDJEN E PËRGJITHSHME NGA FUSHA E SIGURISË DHE SHËNDETIT  
NË PUNË NË KOSOVË

SHKURT, 2025

## Tabela e Përmbajtjes

1. Hyrje.....	3
2. Qëllimi.....	3
3. Metodologjia.....	4
4. Korniza ligjore dhe rregullative.....	4
5. Roli i Institucioneve dhe Partnerëve Ndërkombëtar.....	9
6. Roli i Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferëve.....	9
7. Roli i Inspektoratit të Punës.....	10
8. Roli i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (AKK).....	13
9. Roli i Ministrisë së Shëndetësisë.....	14
10. Roli i Komisionit të Pavarur për Miniera dhe Minerale.....	14
11. Sistemi i menaxhimit të SSHP-së - Standardi ISO 45001.....	15
12. Kompanitë e licensuara për shërbime dhe personat fizikë të certifikuar nga siguria dhe shëndeti në punë.....	16
13. Kontrollat shëndetësore-Roli i Mjekësisë së Punës.....	19
14. Shpërndarja e informacioneve për SSHP.....	21
15. Roli i Organizatave të punëmarrësve dhe organizatave të punëdhënësve në lidhje me zbatimin e legjislacionit për SSHP.....	21
16. Analiza e integritit të SSHP, në programet e studimeve të fushave teknike.....	22
17. Angazhimi i OJQ-ve dhe bashkëpunimi me Institucionet për promovimin e sigurisë dhe shëndetit në punë.....	24
18. Sfidat kryesore të sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë.....	25
19. Rekomandimet.....	26

## **1. HYRJE**

Siguria dhe shëndeti në punë janë pjesë përbërëse e çdo procesi të punës, duke ndërmarrë masat parandaluese që kanë synim përmirësimin e kushteve të punës, mbrojtjen e shëndetit të punëtorëve, përmirësimin e ambientit të punës, mbrojtjen fizike dhe psikike të punëtorëve dhe të tjerëve që marrin pjesë në procesin e punës.

“E drejta për të punuar është një e drejtë e njeriut, që do të thotë se çdo punëtor ka të drejtë për një mjedis pune të shëndetshëm dhe të sigurt”. Promovimi i mirëqenies në punë në të gjitha aspektet e saj është parësor për mbrojtjen e punëtorëve, për ruajtjen e shëndetit të tyre dhe për të siguruar që ata të jenë të motivuar kur bëjnë punën e tyre.

Siguria dhe shëndeti në punë (SSHP) në Kosovë ka marrë një vëmendje në rritje viteve të fundit, si nga sektori privat ashtu edhe nga institucionet shtetërore dhe organizatat ndërkombëtare. Përmirësimi i kushteve të punës dhe krijimi i një ambienti të sigurt dhe të shëndetshëm janë bërë prioritetë për të mbrojtur punonjësit dhe për të reduktuar numrin e aksidenteve në vendin e punës.

Analiza mbi gjendjen e përgjithshme të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP) është përgatitur nga Divizioni për Politikën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, si përgjegjës për zhvillimin, planifikimin dhe koordinimin e sistemit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe politikës së SSHP-së në Kosovë, i cili funksionon në kuadër të Departamentit për Politikën e Punës dhe Punësimin të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transferëve (MFPT).

## **2. QËLLIMI**

Kosova për herë të parë ka hartuar Profilin për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në vitin 2020, i cili pasqyron gjendjen e përgjithshme të sistemit të sigurisë dhe shëndetit në punë në Republikën e Kosovës.

Gjatë katër viteve të fundit, kanë ndodhur disa zhvillime në fushën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, duke u bazuar në këto zhvillime, ka vlerësuar të nevojshëm rishikimin e këtij profili. Ky rishikim është fokusuar në ndryshimet që kanë ndodhur, ndërsa ato pjesë ku nuk ka pasur zhvillime të reja, nuk janë përditësuar.

Për këtë qëllim, Divizioni për Politikën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë, ka filluar përgatitjen e një analize mbi gjendjen e përgjithshme të sigurisë dhe shëndetit në punë në Kosovë.

Qëllimi kryesor i analizës është të ofroj një pasqyrë të gjendjes aktuale të SSHP-së, duke identifikuar mangësitë dhe fushat për përmirësim, me qëllim të përmirësimit të legjislacionit dhe politikave për një ambient më të sigurt pune, duke krahasuar me gjendjen e vlerësuar në vitin 2020. Raporti mbi analizën e situatës së SSHP do të ofroj rekomandime për përmirësimin e situatës duke u bazuar në të gjeturat e këtij raporti.

### 3. METODOLOGJIA

Metodologjia e përdorur gjatë analizës ka përfshirë një kombinim të metodave të kërkimit *desk research* dhe konsultimeve direkte (*face-to-face*). Hapat kryesore janë:

1. **Vlerësimi i bazës ligjore** (*Desk Research*): Analiza e legjislacionit dhe përputhshmëria me direktivat e BE-së për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke përdorur burime të disponueshme dhe dokumente ligjore.
2. **Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave** (*Desk Research*): Grumbullimi i të dhënave nga burime të ndryshme të publikuara, përfshirë raporte dhe të dhëna të institucioneve përkatëse, si dhe OJQ-të dhe burime online.
3. **Konsultime dhe takime me palët e përfshira** (*Face-to-face*): Takime direkte me grupet kyçe, përfshirë biznese, sindikata, kompani të licensuara dhe ekspertë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.
4. **Përdorimi i pyetësorëve** (*Desk Research & Face-to-face*): Përgatitja dhe shpërndarja e pyetësorëve për mbledhjen e informacionit nga grupet e interesit, duke siguruar një pasqyrë të plotë të situatës.
5. **Analizimi i të dhënave dhe pyetësorëve**: Të dhënat e mbledhura janë analizuar dhe vlerësuar për të përgatitur një draft analizë.

### 4. KORNIZA LIGJORE DHE RREGULLATIVE

Kosova ka miratuar legjislacionin përkatës për sigurinë dhe shëndetin në punë. Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, i miratuar në vitin 2013, siguron bazën ligjore për të gjitha aktivitetet që lidhen me SSHP. Përveç këtij ligji, ekzistojnë edhe rregullore të tjera që rregullojnë standardet e sigurisë në sektorë të ndryshëm.

Ky legjislacion, ishte i përafëruar me direktivat e BE-së në fushën e SSHP. Faza e parë e transpozimit të legjislacionit të BE-së, me legjislacionin Kosovar, ishte bërë nga viti 2013 deri me 2017, ku ishin transpozuar gjithsej shtatëmbëdhjetë (17) direktiva të BE-së. Analiza përfshin një krahasim të detajuar të direktivave të transpozuar tashmë dhe identifikon boshllëqet që kanë mbetur. Bazuar në të gjeturat, Direktiva Kornizë 89/391/EC është transpozuar në masë të madhe në Ligjin për SSHP, mirëpo sfidë kryesore mbetet zbatimi i plotë dhe transpozimi i disa dispozitave që kërkojnë rregullime shtesë në Projektligjin për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për siguri dhe shëndet në punë. MFPT tashmë ka identifikuar këto zbrazëtira dhe ka hartuar Projektligjin sipas kërkesave ligjore të kësaj direktive.

Megjithëse korniza ligjore është mjaft e plotë, sfida kryesore qëndron në zbatimin efektiv të kësaj kornize ligjore nga të gjithë akterët e përfshirë në sistemin e SSHP-së.

Dispozitat që mbeten sfidë kryesore për zbatimin e plotë të Ligjit për Sigurinë dhe shëndetin në punë, si dhe për transpozimin në terësi të Direktivës kornizë janë pothuajse të njejtat që janë identifikuar gjatë hartimit të Koncept dokumentit për përmirësimin dhe avancimin e legjislacionit nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, i miratuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës në vitin 2020.

#### **4.1. Analiza e Direktivave individuale të BE-së të transpozuar në aktet nënligjore në Kosovë**

Bashkimi Evropian ka miratuar një sërë direktivash që kërkojnë standarde minimale për të mbrojtur punonjësit nga rreziqet e mundshme që lidhen me kushte të ndryshme të punës. Këto direktiva janë pjesë e një kuadri të gjerë ligjor që synon të promovoj sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien në vendin e punës, duke siguruar një balancë të duhur mes produktivitetit dhe mbrojtjes së punonjësve.

Nga gjithsej njëzet (20) Rregullore të nxjerrura nga ish Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, tani Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve, gjatë kohës së hartimit shtatëmbëdhjetë (17) direktiva individuale janë transpozuar në shtatëmbëdhjetë Rregulloret specifike nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, ndërsa për tri nga to nuk ka pasur Direktiva të BE-së.

Ndonëse janë transpozuar pjesa më e madhe e direktivave të BE-së në legjislacionin kosovar për siguri dhe shëndet në punë, Bashkimi Evropian, viteve të fundit, ka ndryshuar dhe amendamentuar një sërë direktivash.

Direktivat e ndryshuara dhe amendamentuara janë:

- Direktiva 89/654/EEC - Kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës
- Direktiva 89/656/ EEC Përdorimi i Pajisjeve Personale Mbrojtëse;
- Direktiva 98/24/ EEC Rreziqet që lidhen me agjentet kimik në punë;
- Direktiva 2009/ 148 Mbrojtja e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë;
- Direktiva 2004/37 Për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj kancerogjeneve ose mutagjeneve në punë;
- Direktiva 2000/54 Agjentët biologjik në punë.

##### **4.1.1. Direktiva 89/654/EEC - Kërkesat minimale të sigurisë dhe shëndetit në vendin e punës**

Kjo direktivë është ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren e (BE) 2019/1243 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, miratuar më 20 qershor 2019. Kjo Rregullore përshtati disa akte ligjore për të mundësuar përdorimin e procedurës rregullatore me kontroll, sipas neneve 290 dhe 291 të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Ky ndryshim lejon Komisionin Evropian të miratojë akte të deleguara dhe ekzekutive për të zbatuar standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke ruajtur kontrollin nga Këshilli dhe Parlamenti. Rregullorja ka përmirësuar procedurat e miratimit të akteve ligjore, duke siguruar një mbrojtje më të lartë për punonjësit dhe përmirësuar harmonizimin e legjislacionit në të gjithë Bashkimin Evropian. Ndonëse është ndryshuar dhe plotësuar kjo direktivë, në bazë të një analize fillestare, nuk është identifikuar ndonjë kërkesë ligjore që duhet Kosova tani të ndryshoj legjislacionin përkatës që është në fuqi.

#### **4.1.2. Direktiva 89/656/EEC – Përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse në punë**

Direktiva 89/656/EEC e Bashkimit Evropian përcakton kërkesat minimale për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) në vendin e punës, duke synuar mbrojtjen e punonjësve nga rreziqet e ndryshme që mund të çenojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre. Direktiva 2019/1832, e miratuar më 24 tetor 2019, ka bërë ndryshime teknike në anekset I, II dhe III të Direktivës 89/656/EEC, e cila përcakton kërkesat minimale për përdorimin e pajisjeve personale mbrojtëse (PPM) në vendin e punës.

Anekset I, II dhe III të Direktivës 89/656/EEC janë zëvendësuar me një tekst të ri që përditëson:

- Listën e rreziqeve për të cilat kërkohen PPM, duke specifikuar më qartë pjesët e trupit që duhen mbrojtur.
- Kategoritë e pajisjeve mbrojtëse, duke shtuar detaje për mbrojtjen e kokës, syve, dëgjimit, frymëmarrjes, duarve, këmbëve, trupit dhe mbrojtjen nga rënia.
- Sektorët e punës që kërkojnë PPM, duke përfshirë industrinë e ndërtimit, metalurgjinë, laboratorët, bujqësinë dhe shëndetësinë.

Këto ndryshime synojnë të sigurojnë që legjislacioni i BE-së për PPM të mbetet i përditësuar dhe në përputhje me zhvillimet e fundit në teknologji dhe praktikat e punës, duke garantuar kështu një nivel të lartë të mbrojtjes për punëtorët në të gjithë Bashkimin Evropian.

#### **4.1.3. Direktiva 98/24/EEC – Rreziqet që lidhen me agjentët kimik në vendin e punës.**

**Ndryshimet kryesore në Direktivën 98/24/KE dhe 2000/39/KE** – përfshijnë krijimin e një liste të pestë të vlerave treguese të limitit të ekspozimit në punë sipas Direktivës 98/24/KE të Këshillit dhe ndryshimit të Direktivës 2000/39/KE;

- Vendosjen e **një liste të pestë** të vlerave treguese të BE-së për kufirin e ekspozimit në punë për disa agjentë kimik specifik.
- Shtetet anëtare duhet të përcaktojnë vlerat kombëtare të ekspozimit, duke marrë parasysh standardet e BE-së.

Në shtojcën e përditësuar, janë përcaktuar vlerat kufitare për disa kimikate si Aniline, Kloromethane, Trimethylamine, Acetate Butyl, etj.

- Për secilin kimikat, janë përcaktuar kufijtë për ekspozim 8-orësh dhe ekspozim afatshkurtër, si dhe përbërësit me rrezik përmes lëkurës.

#### **4.1.4. Direktiva 2009/ 148 Mbrojtja e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë**

**Direktiva (BE) 2023/2668 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit** e miratuar më 22 nëntor 2023, ka **ndryshuar Direktivin 2009/148/EC për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj asbestit në punë.**

Kjo është një direktivë e re e cila ka sjellë përditësime dhe ndryshime për të përmirësuar mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet e ekspozimit ndaj asbestit në punë.

### **Ndryshimet kryesore në këtë direktivë përfshijnë:**

- Përkufizimi i asbestit – Konfirmimi si kancerogjen i kategorisë 1A, përfshirja e 6 llojeve të asbestit.
- Kufizimi i ekspozimit – Kufiri maksimal reduktohet në 0.002 fibra/cm<sup>3</sup> deri në 2029.
- Forcimi i vlerësimit të rrishtit – Detyrim për punëdhënësit të kryejnë vlerësime të detajuara para punës me asbest.
- Kërkesa më të rrepta për trajtimin e mbetjeve – Transporti dhe ruajtja duhet të bëhen në paketim të mbyllur.
- Rregulla të reja për monitorimin – Matje të rregullta të ajrit dhe përfshirja e fibrave nën 0.2 mikrometra në analizat e ekspozimit.
- Kërkesa të reja për trajnim dhe licencim – Trajnim i detyrueshëm dhe licencim i kompanive që punojnë me asbest.
- Regjistri i sëmundjeve nga asbesti – Detyrim për shtetet anëtare të mbajnë një bazë të dhënash për rastet e ekspozimit dhe sëmundjet profesionale.

#### **4.1.5. Direktiva 2004/37/EC – Për mbrojtjen e punëtorëve nga rreziqet që lidhen me ekspozimin ndaj substancave kancerogjene dhe mutagjene në vendin e punës.**

Kjo direktivë ka qenë subjekt i ndryshimeve të shpeshta që nga viti 2017 e tutje. Ndryshimet sipas viteve dhe direktivave përkatëse janë si në vijim:

- Amendimet e vitit 2017 (Direktiva 2017/2398/EU)
- Amendimet e hershme të vitit 2019 (Direktiva 2019/130/EU)
- Amendimet e mesme të vitit 2019 (Direktiva 2019/983/EU)
- Amendimet e vitit 2022 (Direktiva 2022/431/EU)
- Amendimet e vitit 2024 (Direktiva 2024/431/EU)

### **Ndryshimet kryesore në këtë direktivë përfshijnë:**

- Substancat reprotoksike janë shtuar në fushën e kësaj direktive, duke përfshirë një ndarje të re midis:
- Substancave reprotoksike jo-prag, për të cilat nuk ka nivel të sigurt të ekspozimit.
- Substancave reprotoksike pragu, për të cilat ekziston një nivel i sigurt i ekspozimit.

Përditësimi i aktiviteteve të rrezikshme, në Shtojcën I, janë shtuar aktivitetet e mëposhtme si veprimtari me rrezik të lartë:

- Ekspozimi ndaj vajrave minerale të përdorura më parë në motorët me djegie të brendshme.
- Ekspozimi ndaj emetimeve të shkarkimit të motorëve me naftë.

Kufizime të reja të ekspozimit për disa substanca të rrezikshme, janë vendosur në Shtojcën III, për disa agjentë të rrezikshëm, si:

- Benzene – Kufiri i ri prej 0.2 ppm nga 5 prilli 2026.
- Pluhuri i drurit të fortë – Kufiri i ekspozimit të reduktuar nga 3 mg/m<sup>3</sup> në 2 mg/m<sup>3</sup> deri më 17 janar 2023.

- Komponentet e Kromit (VI) – Kufiri i ekspozimit do të ulet në 0.005 mg/m<sup>3</sup> deri më 17 janar 2025.
- Pluhuri i silicit kristalor – Vlera maksimale 0.1 mg/m<sup>3</sup>.
- Formaldehid – Kufiri i ri 0.3 ppm për ekspozim 8-orësh.
- Plumbi dhe komponimet e tij – Reduktimi gradual i nivelit të plumbit në gjak nga 30 µg/100 ml deri më 2028 dhe 15 µg/100 ml nga 2029.

Masa të reja për mbrojtjen e punëtorëve

- Punëdhënësit duhet të zëvendësojnë substancat kancerogjene ose reprotoksike me alternativa më të sigurta, kur është teknikisht e mundur.
- Nëse zëvendësimi nuk është i mundur, ekspozimi duhet të reduktohet në minimumin teknikisht të mundur.
- Në rast të përdorimit të substancave të rrezikshme, duhet të zbatohet një monitorim i rreptë i kushteve të punës

#### **4.1.6. Direktiva 2000/54/EC – Agjentët biologjik në punë.**

Direktiva 2000/54/EC, ishte ndryshuar dhe plotësuar me këto direktiva:

- Direktiva e Komisionit (BE) 2019/1833 e 24 tetorit 2019
- Direktiva e Komisionit (BE) 2020/739 e 3 qershorit 2020

#### **Ndryshimet kryesore në këtë direktivë përfshijnë:**

##### 1. Zëvendësimi i anekseve kryesore

- Aneks I, III, V dhe VI janë zëvendësuar me versione të përditësuara.
- Përditësimet përfshijnë klasifikime të reja për agjentët biologjik, masa mbrojtëse dhe rregulla për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse në ambientet e punës.

##### 2. Klasifikimi i ri i agjentëve biologjik (Aneksi III)

- Përditësimi i listës së agjentëve biologjik bazuar në ndikimin e tyre tek punëtorët e shëndetshëm.
- Përfshirja e patogjenëve të kafshëve dhe bimëve, përveç në rastet kur dihet se kanë ndikim te njeriu.
- Shtimi i agjentëve të ri biologjik, përfshirë SARS-CoV-2, duke e klasifikuar atë në grupin 3 të rrezikut.
- Përcaktimi i rreziqeve të mundshme alergjike dhe toksike për disa mikroorganizma.

##### 3. Shtimi i aktiviteteve me rrezik të lartë (Aneksi I)

Në listën e aktiviteteve të punës me rrezik të lartë nga ekspozimi ndaj agjentëve biologjik janë shtuar:

- Punët në fabrikat e prodhimit të ushqimit.
- Punët në bujqësi.
- Kontakti me kafshë ose produkte me origjinë shtazore.

- Shërbimet shëndetësore dhe labororet diagnostikues.
- Impiantet e asgjësimit të mbeturinave dhe pastrimi i ujërave të zeza.

#### 4. Masa të reja për frenimin dhe sigurinë (Aneksi V dhe VI)

- Rritja e standardeve të mbrojtjes në laboratore dhe industri për të minimizuar ekspozimin ndaj agjentëve biologjik.
- Vendosja e kufizimeve më të rrepta për transportin, ruajtjen dhe asgjësimin e mbetjeve të kontaminuara.
- Forcimi i masave të izolimit dhe dezinfektimit në rast ekspozimi të lartë.

### **Rekomandim për Harmonizimin e Legjislacionit mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Kosovë**

Bazuar në identifikimin e ndryshimeve në direktivat e BE-së që nga viti 2017 e tutje, Divizioni për Politikat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë do të nisë një proces të thelluar të analizimit të secilës direktivë të përditësuar. Në bazë të gjetjeve nga kjo analizë, do të propozohet ndryshimi dhe plotësimi i rregulloreve përkatëse në fuqi, duke siguruar përafrimin me standardet e BE-së.

Ky proces do të mundësoj përmirësimin e mbrojtjes së punëtorëve dhe krijimin e kushteve më të sigurta dhe të shëndetshme të punës në Kosovë.

## **5. ROLI I INSTITUCIONEVE DHE PARTNERËVE NDËRKOMBËTAR**

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve vendore dhe partnerëve ndërkombëtar, si Organizata Ndërkombëtare e Punës (ILO) dhe Bashkimi Evropian, ka qenë i rëndësishëm për zhvillimin e fushës së SSHP në Kosovë. Programet e financuara nga donatorët dhe asistencat teknike kanë ndihmuar në krijimin e kapaciteteve dhe trajnimin e inspektorëve të punës.

Falë ndihmës ndërkombëtare, janë realizuar disa projekte që kanë përmirësuar kualifikimin e profesionistëve dhe kanë rritur ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e SSHP. Megjithatë, për një përmirësim të qëndrueshëm, Kosova duhet të krijoj një sistem të qëndrueshëm financiar dhe administrativ për këtë fushë.

### **5.1. ROLI I MINISTRISË SË FINANCEVE, PUNËS DHE TRANSFERËVE**

Me hyrjen në fuqi të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, ish-Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale është bashkuar me Ministrinë e Financave, duke marrë emërtimin e ri “Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve” (MFPT).

Pas ristrukturimit të MFPT-së, në bazë të Rregullores Nr. 02/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës, në kuadër të Departamentit për Politikat e Punës dhe Punësimit është krijuar një divizion i ri – **Divizioni për Politikat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**. Ky divizion është përgjegjës për iniciimin dhe hartimin e politikave në këtë fushë, duke përfaqësuar një hap të rëndësishëm drejt fuqizimit të sigurisë dhe shëndetit në punë. Për më tepër, ai është zgjeruar edhe me staf, duke arritur një numër prej pesë

zyrtarësh. Gjithashtu, divizioni monitoron gjendjen e sistemit të sigurisë në punë, përmes sistemit të informacionit të sigurisë në punë.

Në fund të dhjetorit 2024, MFPT ka lansuar një platformë elektronike E-Kosova, e cila u mundëson punëtorëve dhe punëdhënësve të ndjekin trajnime bazike në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Aktualisht, platforma është në fazën fillestare të zbatimit, dhe ende nuk është filluar vlerësimi për numrin e pjesëmarrësve të trajnuar.

Përveç kësaj, MFPT ka shënuar një tjetër përparim në shpërndarjen e informacionit mbi sigurinë dhe shëndetin në punë përmes hapjes së një faqeje të re të internetit. Në këtë faqe është krijuar një dritare me burim informatash për fushën e SSHP, duke filluar me intricionet përkaëse të SSHP, vazhduar me publikimin e dokumenteve të rëndësishme, përfshirë legjislacionin, manuale, broshura, lista kontrolluese dhe materiale të tjera informuese, të cilat janë të aksesueshme përmes portalit "**Puna**", në seksionin dedikuar Sigurisë dhe Shëndetit në Punë.

## **5.2. ROLI I INSPEKTORATIT TË PUNËS**

Në vitet e fundit, Inspektorati i Punës në Kosovë ka filluar me një reformë të rëndësishme drejt modernizimit dhe rritjes së efikasitetit të inspektimeve. Reforma ka filluar me miratimin e një strukture të re organizative, e cila ka synuar rritjen e efikasitetit dhe forcimin e kapaciteteve për mbikëqyrjen e kushteve të punës. Një nga ndryshimet kryesore ka qenë rritja e numrit të inspektorëve të rinj, të cilët janë trajnuar për t'u përballur me sfidat e reja të sigurisë dhe shëndetit në punë.

Për më tepër, Inspektorati ka ofruar trajnimet e nevojshme dhe të vazhdueshme për inspektorët, duke u mundësuar atyre zhvillimin profesional dhe përshtatjen me praktikën më të fundit të inspektimit dhe kërkesat ligjore. Kjo ka kontribuar në përmirësimin e efikasitetit të inspektimeve dhe mbikëqyrjes.

Gjithashtu, është duke u ndërtuar një sistem i ri inspektimi që përfshin dixhitalizimin për të përmirësuar procesin e mbikëqyrjes, duke mundësuar regjistrimin dhe monitorimin më të mirë të vizitave të inspektorëve, si dhe për të përmirësuar komunikimin dhe koordinimin ndërmjet institucioneve të ndryshme.

Një arritje tjetër ka qenë anëtarësimi i Inspektoratit të Punës në disa organizata ndërkombëtare, duke mundësuar shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira me institucione të tjera nga vende të ndryshme. Reforma ka kontribuar në forcimin e transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke ndihmuar në krijimin e kushteve më të sigurta për punonjësit në vendin e punës.

### **5.2.1. Ngritja e kapaciteteve profesionale**

Gjatë vitit 2023, janë rekrutuar gjithsej 30 inspektor të rinj dhe gjatë fundit të vitit 2024 kanë qenë në proces të rekrutimit edhe disa inspektor të rinj, proces ky i cili ende nuk është përfunduar.

Aktualisht numri i përgjithshëm i inspektorëve të punës që ushtrojnë funksionin e tyre në tërë territorin e Republikës së Kosovës është 62. Ndër ta, 44 janë burra dhe 18 janë gra.


Sipas strukturës profesionale: 38 inspektor janë nga drejtimi juridik, 4 nga teknologjia ushqimore dhe bioteknologjia, 4 nga inxhinieria e mekanikës, 4 nga kimia, 3 nga drejtimi ekonomik, 2 nga drejtimi i ndërtimtarisë/arkitekturës, 2 nga biologjia dhe 5 inspektorë të tjerë i takojnë drejtimeve si hidroteknika, menaxhment - informatikë, shkenca politike, xehtari dhe metalurgji, si dhe agroekonomi.

### 5.2.2. Të dhënat statistikore të inspektimeve

Parregullsitë më të shpeshta të evidentuara nga Inspektorati i Punës nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë kanë qenë: mungesa e trajnimit të punëtorëve, mungesa e vlerësimit të riskut në vendin e punës, (mos) përdorimi i pajisjeve personale mbrojtëse, dhe numri i ulët i kontrollave mjekësore. Për të gjitha këto parregullsi Inspektorati i punës ka ndërmarrë masat administrative si vërejtje, masa ndëshkuese-gjybara, dhe pezullime punimesh.

Seksioni përmbledh të dhënat nga inspektimet, duke përfshirë inspektimet e aksidenteve, të jashtëzakonshme dhe të planifikuara, dhe shfaq një analizë të trendeve që reflekton uljen e numrit të aksidenteve fatale në vendin e punës ndër vite.

Sipas këtyre raporteve shihet se ka pasur rritje të numrit të inspektimeve ndër vite, pra kjo rritje vërehet gjatë vitit 2023 krahasuar me vitin 2022, si dhe rritje është shënuar edhe gjatë vitit 2024 krahasuar me vitin 2023.




Numrin dhe llojet e inspektimeve për vitin 2022, 2023 dhe 2024 i kemi paraqitur në tabelën si më poshtë:

Llojet e inspektimeve	2022	2023	2024
Inspektime të Aksidenteve	405	330	601
Inspektime të Jashtëzakonshme	46	44	
Inspektime të përseritura	1602	2770	
Inspektime të planifikuara	3323	3874	4444
Sipas Ankesës	860	1348	1321
Të përbashkëta	81	280	360
Të paplanifikuara			360
Ri-inspektime			4925
	6317	8646	12011
<b>Totali</b>	<b>26,974</b>		

Gjatë vitit 2023<sup>1</sup> janë realizuar 8,172 trajnime nga punëdhënësit për punëtorët, ndërsa gjatë vitit 2024<sup>2</sup> janë realizuar 4118 trajnime nga punëdhënësit për punëtorët.

Gjithashtu në raportin vjetor të punës nga IP-ja, janë të publikuara edhe aksidentet e rënda dhe ato me fatalitet sipas veprimtarisë, ku numri më i madh i aksidenteve të rënda është në industrinë e ndërtimtarisë, pastaj në industrinë e prodhimit.

Lidhur me numrin e aksidenteve me fatalitet në vendin e punës sipas raportit vjetor të punës nga IP-ja, shihet se ka pasur ulje të aksidenteve me fatalitet në vendin e punës gjatë vitit 2023 dhe 2024, krahasuar me vitin 2022<sup>3</sup>, e cila është paraqitur në tabelën si më poshtë:



<sup>1</sup>[ip.rks-gov.net/?p=4360](http://ip.rks-gov.net/?p=4360)

<sup>2</sup> [ip.rks-gov.net/?p=4367](http://ip.rks-gov.net/?p=4367)

<sup>3</sup> [ip.rks-gov.net/ëp-content/uploads/Raporti-Vjetor-2022-IP.pdf](http://ip.rks-gov.net/ëp-content/uploads/Raporti-Vjetor-2022-IP.pdf)

Raporti i Progresit për Kosovën për vitin 2024 ka evidentuar se Inspektorati i Punës ka zgjeruar kapacitetet e tij dhe ka intensifikuar inspektimet në sektorët me rrezikshmëri të lartë, duke parë rënie të aksidenteve me fatalitet.

#### **Rekomandimet:**

1. **Trajnimi i vazhdueshëm i inspektorëve:** Sigurimi i trajnimeve të avancuara për inspektorët, duke u fokusuar në sektorët me rrezikshmëri të lartë, si ndërtimtaria dhe prodhimi.
2. **Forcimi i inspektimeve në sektorët e rrezikshëm:** Rritja e inspektimeve dhe monitorimit në sektorët që shkaktojnë aksidente të shumta, me fokus në parandalimin e aksidenteve fatale.
3. **Zhvillimi i planit të inspektimit për sektorët e rrezikshëm:** Hartimi i një plani të veçantë inspektimi për sektorët me rrezikshmëri të lartë dhe rritja e numrit të inspektorëve të specializuar.
4. **Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe ndërinstytucional:** Forcimi i bashkëpunimit me agjencitë ndërkombëtare dhe përmirësimi i koordinimit me institucionet shtetërore dhe private për një mbikëqyrje të integruar.
5. **Dixhitalizimi i inspektimeve:** Vazhdimi i dixhitalizimit të procesit të inspektimeve për të mundësuar mbikëqyrje më efikase dhe të dokumentuar.
6. **Vlerësimi i riskut dhe trajnimi i punëtorëve:** Fokusimi në vlerësimin e riskut dhe trajnimin e punëtorëve për përdorimin e pajisjeve mbrojtëse për të parandaluar aksidentet.
7. **Analiza e të dhënave statistikore:** Zhvillimi i një sistemi për analizimin e të dhënave mbi aksidentet dhe identifikimin e sektorëve me rrezikshmëri të lartë për të përmirësuar politikat dhe praktikatat e sigurisë.

#### **5.3. ROLI I MINISTRISË SË ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË DHE AUTORITETIT KOMBËTAR TË KUALIFIKIMEVE (AKK)**

Siguria dhe shëndeti në punë duhet integruar në politikat arsimore si një komponent kyç për zhvillimin e një fuqie punëtore të kualifikuar dhe të vetëdijshme për standardet e punës., Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) ka shënuar progres në këtë drejtim, duke avancuar edukimin dhe trajtimin e këtyre çështjeve brenda sistemit të kualifikimeve dhe arsimit profesional.

Një ndër institucionet kryesore që ka kontribuar në këtë fushë është Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK), një organ i pavarur publik, i themeluar nga MASHT i cili operon në përputhje me Ligjin nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare. AKK ka luajtur një rol kyç në integrimin e kriterëve të sigurisë dhe shëndetit në punë brenda sistemit të kualifikimeve, duke vendosur standarde më të avancuara për akreditimin e institucioneve që ofrojnë aftësim profesional nga ofrues jopublik. Kjo ka ndikuar drejtpërdrejt në ngritjen e cilësisë së arsimit profesional dhe përgatitjen e kuadrove të aftë për të përmbushur kërkesat e tregut të punës.

Në të njëjtën kohë, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional, e cila funksionon në kuadër të MASHT-it, ka ndërmarrë hapa konkret për përfshirjen e sigurisë dhe shëndetit në punë në pjesën e edukimit dhe trajnimit profesional për të rinjtë dhe të rriturit. Kjo qasje ka për qëllim jo vetëm rritjen e ndërgjegjësimit të nxënësve dhe profesionistëve të ardhshëm mbi rreziqet

në ambientin e punës, por edhe pajisjen e tyre me aftësi praktike dhe njohuri të nevojshme për të zbatuar standardet e sigurisë në sektorët përkatës.

#### **Rekomandim:**

Për të forcuar më tej integrimin e sigurisë dhe shëndetit në punë në sistemin arsimor, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) duhet të ndërmarrë hapa shtesë drejt përmirësimit të kurrikulave dhe standardeve të aftësisë profesionale. Këto masa mund të përfshijnë:

- **Thellimin e bashkëpunimit me industrinë dhe ekspertët e fushës**, për të siguruar që trajnimet dhe kualifikimet përputhen me nevojat reale të tregut të punës.
- **Zhvillimin e moduleve të detyrueshme për sigurinë dhe shëndetin në punë** në të gjitha programet e arsimit dhe aftësisë profesionale.
- **Investimin në trajnimin e mësimdhënësve dhe instruktorëve**, për të garantuar një qasje cilësore dhe të përditësuar në këtë fushë.
- **Monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të këtyre standardeve**, për të siguruar që institucionet arsimore dhe ofruesit e aftësisë profesionale i respektojnë dhe i aplikojnë me efektivitet.

#### **5.4. ROLI I MINISTRISË SË SHËNDETËSISË**

Ministria e Shëndetësisë ka shënuar progres në qershor të vitit 2022 me hapjen e specializimeve për mjekësinë e punës, duke ndarë pesë vende për këtë fushë. Programi i shkollimit specialistik për këta mjekë ka filluar në mars të vitit 2021 deri në dhjetor 2024, ku tre prej tyre kanë përfunduar me sukses këtë specializim. Ky hap përfaqëson një zhvillim të rëndësishëm në fuqizimin e kapaciteteve profesionale në fushën e shëndetit në punë.

Sa i përket avancimeve legislative, gjatë vitit 2024, Ministria e Shëndetësisë ka nisur hartimin e Projektligjit për Shëndetësi, i cili ka kaluar në fazën e konsultimeve publike. Ky projektligj parasheh që mjekësia e punës të rregullohet përmes një ligji të veçantë, mirëpo ende nuk është miratuar.

Megjithatë, një ndër sfidat kryesore mbetet mungesa e një kuadri të zhvilluar ligjor për sëmundjet profesionale, çka krijon vakum në identifikimin, trajtimin dhe parandalimin e tyre.

#### **Rekomandim:**

Ministria e Shëndetësisë duhet të përshpejtoj procesin e miratimit të Projektligjit për Shëndetësi, hartimit të ligjit të veçantë për mjekësinë e punës, si dhe të iniciojë hartimin e një legjislacioni të posaçëm për sëmundjet profesionale. Kjo do të mundësonte një qasje më të strukturuar në parandalimin, diagnostikimin dhe trajtimin e këtyre sëmundjeve, duke garantuar mbrojtje më të mirë për punëtorët dhe përmirësuar kushtet e sigurisë dhe shëndetit në punë.

#### **5.5. ROLI I KOMISIONIT TË PAVARUR PËR MINIERA DHE MINERALE**

Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale ka përgjegjësinë kryesore për zbatimin dhe monitorimin e rregulloreve të sigurisë në sektorin minerar, në përputhje me Ligjin nr. 05/L-062, për Sigurinë në Punë në Veprimtarinë Minerare. Ky Komision ka rol kyç në sigurinë dhe

mbrojtjen e punonjësve në miniera dhe objekte përpunuese, duke siguruar që të gjitha aktivitetet minerare të kryhen në përputhje me standardet e sigurisë dhe mbrojtjes.

Përmes përgjigjeve të dhëna në pyetësonin e plotësuar nga Komisioni, është evidentuar se ky institucion kryen inspektime të rregullta dhe të jashtëzakonshme në objektet minerare dhe ato përpunuese. Komisioni mbledh dhe analizon të dhëna të detajuara mbi aksidentet në sektorin minerar përmes një sistemi të strukturuar dhe të rregulluar, që ndihmon në identifikimin dhe parandalimin e rreziqeve të mundshme.

Megjithatë, janë identifikuar disa sfida të rëndësishme që ndikojnë në përmirësimin e sigurisë në sektorin minerar. Sfidat kryesore përfshijnë mosaktivizimin e disa rregulloreve të rëndësishme, përfshirë ato që lidhen me masat mbrojtëse në përdorimin e eksplozivëve, dhe mungesën e bashkëpunimit të ngushtë me organizatat dhe sindikatat për avancimin e sigurisë në punë.

**Si rekomandime** për përmirësim, Komisioni ka theksuar nevojën për miratimin dhe zbatimin e rregulloreve të mbetura sipas Ligjit nr. 05/L-062, si dhe zhvillimin e trajnimeve të specializuara për punonjësit e sektorit minerar. Gjithashtu, është theksuar rëndësia e përfshirjes aktive të sindikatave në procesin e vendimmarrjes, për të siguruar që kërkesat dhe shqetësimet e punonjësve të merren parasysh. Rekomandohet gjithashtu intensifikimi i inspektimeve dhe krijimi i mekanizmave efektiv për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve dhe përmirësimin e kushteve të sigurisë në sektorin minerar.

Në këtë kontekst, përmirësimi i bashkëpunimit ndër-institucional, përfshirë edhe me organizatat ndërkombëtare që merren me sigurinë në punë, si dhe implementimi i masave për forcimin e kapaciteteve të Komisionit, janë të domosdoshme për të arritur standarde më të larta të sigurisë dhe mbrojtjes në sektorin minerar. Kjo do të kontribuonte në parandalimin e aksidenteve dhe përmirësimin e kushteve të punës për punonjësit e këtij sektori të rëndësishëm.

## **5.6. SISTEMI I MENAXHIMIT TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË - STANDARDI ISO 45001**

Standardi ISO 45001 për Sistemin e Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë (SSHP) është një mjet i rëndësishëm për parandalimin e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, të cilat mund të kenë ndikim të madh negativ në bizneset dhe punëtorët. Ky standard ofron një kornizë për krijimin dhe menaxhimin e kushteve të sigurta dhe të shëndetshme në punë, duke kontribuar në përmirësimin e kulturës së sigurisë dhe në zvogëlimin e rrezikut të aksidenteve dhe sëmundjeve.

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se, edhe pse implementimi i këtij standardi është një përfitim i rëndësishëm për kompanitë, krijimi i një Sistemi të Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë nuk është i detyrueshëm për punëdhënësit sipas ligjit. Ky standard ka ardhur si rezultat i ngritjes së vetëdijesimit të punëdhënësve për rëndësinë e sigurisë dhe shëndetit në punë. Shumë kompani kanë vendosur të implementojnë ISO 45001 për të përmirësuar kushtet e sigurisë dhe për të rritur performancën e tyre, duke iu përshtatur praktikave ndërkombëtare dhe duke kontribuar në një ambient pune më të sigurt për punëtorët.

Kompanitë që zgjedhin të implementojnë këtë standard dhe të kërkojnë çertifikimin ISO 45001, duhet të kalojnë një proces të detajuar të përgatitjes dhe aplikimit për çertifikimin nga një institucion të njohur të çertifikimit. Ky proces është përgjegjësi e plotë e firmës dhe, për momentin, nuk ka ndonjë detyrim ligjor për të pasur një çertifikatë të tillë, por ajo përfaqëson një përfitim të rëndësishëm në përmirësimin e kushteve të punës dhe në rritjen e performancës organizative.

Në vitet e fundit, një numër i kompanive në Kosovë kanë zbatuar standardin ISO 45001 për të përmirësuar kulturën e sigurisë në vendin e punës dhe për të rritur performancën e tyre në përputhje me praktikën ndërkombëtare. Implementimi i këtij standardi është një hap përpara në drejtim të modernizimit të menaxhimit të sigurisë dhe përmirësimit të kushteve të punës, duke u bazuar në një qasje të sistemuar dhe të strukturuar për menaxhimin e rreziqeve dhe sigurisë në punë.

Disa nga kompanitë dhe ndërmarrjet që janë çertifikuar me standardin ISO 45001 janë:

- **Kompania Kosovare për Distribim me Energji Elektrike (KEDS SH.A.)**, çertifikuar me ISO 45001 në vitin 2018.
- **Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut të Kosovës (KOSTT SH.A.)**, i çertifikuar në vitin 2021 me katër (4) standarde: ISO 9001 (Sistemi i Menaxhimit të Cilësisë), ISO 14001 (Sistemi i Menaxhimit Mjedisor), ISO 45001 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë), dhe ISO 27001 (Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit).
- **Sharrcem**, çertifikuar me ISO 45001 që nga viti 2020, pas një periudhe çertifikimi me standardin OHSAS 18001 nga viti 2013.
- **Terminali Cement Plus në Lipjan**, çertifikuar me ISO 45001 në vitin 2023.
- **Kompania NeëCo Feronikeli**, e çertifikuar me ISO 45001 në vitin 2022 nga trupa çertifikuese SGS.
- **Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO SH.A.)**, çertifikuar me ISO 45001 në vitin 2018.

Implementimi i standardit ISO 45001 për SSHP ka qenë një përfitim i rëndësishëm për këto kompani, duke u mundësuar atyre përmirësimin e kushteve të sigurisë në punë, rritjen e efikasitetit operativ dhe zvogëlimin e rreziqeve që mund të ndikojnë në shëndetin e punëtorëve dhe të rrisin produktivitetin e organizatës. Ky standard gjithashtu ka kontribuar në forcimin e besueshmërisë dhe reputacionit të këtyre kompanive si akterë të përgjegjshëm dhe të orientuar drejt përmirësimit të kushteve të punës.

## **6. KOMPANITË E LICENCUARA PËR SHËRBIME DHE PERSONAT FIZIK TË CERTIFIKUAR NGA SIGURIA DHE SHËNDETI NË PUNË**

Pas miratimit të **Rregullores së re (MPMS) nr. 01/2021** për kualifikimin e personave përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë dhe licencimin e kompanive të shërbimeve dhe trajnimeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, e cila hyri në fuqi në prill të vitit 2021, është vërejtur një rritje e ndjeshme e kërkesave për çertifikimin si ekspertë të sigurisë dhe shëndetit në punë, si dhe për licencimin e qendrave për ofrimin e shërbimeve dhe trajnimeve. Ky ndryshim ka nxitur një vetëdijësim të shtuar nga ana e punëdhënësve, por edhe nga vetë punëtorët, lidhur me rëndësinë e angazhimit të personave përgjegjës për SSHP, si dhe

trajnimin dhe informimin e tyre për t'u siguruar që dispozitat e Ligjit për Siguri dhe Shëndet në Punë zbatohen në mënyrë efikase.

Ky proces ka kontribuar në forcimin e kulturës së sigurisë dhe shëndetit në punë në nivel nacional, duke krijuar mundësi për trajnime dhe vlerësime të rrishtit më të strukturuar. Gjithashtu, është bërë më e qartë që përfshirja e ekspertëve të kualifikuar për sigurinë dhe shëndetin në punë ka një ndikim pozitiv në përmirësimin e kushteve të punës dhe zvogëlimin e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale.

Sipas raporteve të siguruar nga **Divizioni për Politikën e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë**, i cili është përgjegjës për monitorimin e gjendjes, përmes Sistemit të Informacionit të Sigurisë në Punë, kompanitë e licencuara për ofrimin e shërbimeve dhe trajnimeve, kanë shënuar rritje të vazhdueshme të aktivitetit në këtë sektor që nga viti 2021. Kjo ka përfshirë një rritje të numrit të vlerësimeve të rrishtit dhe trajnimeve për punëtorët, si dhe përfshirjen e një numri më të madh të punëdhënësve që janë angazhuar në përmbushjen e detyrimeve ligjore të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë.

Aktualisht, janë 21 kompani të licencuara që ofrojnë shërbime nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, dhe gjithsej 9 qendra që ofrojnë trajnime për sigurinë dhe shëndetin në punë.

### **Krahasimi i Aktivitetit të Kompanive të Licencuara në Vitin 2023 dhe 2024**

Në vitin 2023 dhe 2024, aktivitetet e trajnimit dhe vlerësimit të rrishtit nga kompanitë e licencuara kanë pasur një tendencë të vazhdueshme rritjeje.

### **Numri i ekspertëve të çertifikuar (2017-2024):**

- Gjithsej **294 ekspertë** të çertifikuar për siguri dhe shëndet në punë, prej tyre **233 burra dhe 61 gra**.
- Gjithsej **305 specialist themelor**, prej tyre **238 burra dhe 67 gra**
- Gjithsej **219 specialist të avancuar**, prej tyre **187 burra dhe 32 gra**.
- Gjithsej **39 trajnerë**, prej tyre **33 burra dhe 6 gra**.

Kjo tregon një përfshirje më të madhe të gruas në këtë sektor, që është një shenjë e inkurajueshme për barazinë gjinore dhe rritjen e diversitetit në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Ekspertët e çertifikuar në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë janë të profesioneve të ndryshme, ku prijnë juristët, pra 43 prej tyre janë juristë, 41 inxhinierë të makinerisë, 29 menaxhim të emergjencave, 22 inxhinierë të ndërtimtarisë, 16 inxhinierë elektrikë, 13 arkitektë dhe 10 inxhinierë të xehtarisë. Ndërkohë, profesionet e tjera si mjekësia, psikologjia, shkenca kompjuterike, shkenca matematikore, inxhinieria e ambientit, inxhinieria e aviacionit, menaxhmenti industrial, kimia, fizika, bujqësia, gjeodezia, mbrojtja e mjedisit, dhe disa të tjera të ngjashme, janë të përfaqësuara me nga 9 deri në 1 ekspert.

### Trajnimet e ofruara:

- Gjatë vitit **2023, 916 punëdhënës** kanë përbushur obligimin ligjor për trajnimin e punëtorëve, duke treguar një rritje të vetëdijes dhe angazhimit nga ana e kompanive për t'u përbushur me rregullat e sigurisë.
- Gjatë vitit **2024, 871 punëdhënës** kanë kryer trajnime për punëtorët, duke ruajtur një nivel të lartë të angazhimit dhe duke mundësuar një zhvillim të qëndrueshëm të sigurisë dhe shëndetit në punë.

### Vlerësimet e Riskut:


- Nga viti **2018 deri në vitin 2024**, janë kryer gjithsej **1,577 vlerësime të riskut** në industri me rrezik të ulët, ndërsa vlerësime në industri me risk të lartë janë kryer gjithsej **1,747**. Kjo tregon një përpjekje të vazhdueshme për të identifikuar dhe menaxhuar rreziqet që mund të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e punëtorëve, duke siguruar një ambient pune më të sigurt dhe më të shëndetshëm për të gjithë punëtorët.

Numri i përgjithshëm i vlerësimeve të riskut të kryer në industrinë me risk të ulët, risk të lartë dhe sipas industrive gjatë viteve 2018 – 2024, është paraqitur në tabelën si në vijim:

Vlerësime të riskut	2024	2023	2022	2021	2020	2019	2018
Dokumente të vlerësimeve të riskut	980	953	752	516	374	619	302
Vlerësime të riskut të kryer në industrinë më risk të ulët:	360	574	383	260	/	/	/
Vlerësime të riskut të kryer në industrinë më risk të lartë:	620	379	369	256	/	/	/
Ndërtim	314	212	171	128	/	/	/
Prodhim	265	120	132	109	/	/	/
Miniera	7	5	10	6	/	/	/
Bujqësi	6	0	5	1	/	/	/
Transport	10	27	6	3	/	/	/
Të tjera (Energji)	83	73	45	9	/	/	/

Krahasimet për vitet 2021-2024 të vlerësimeve të riskut të kryera në industrinë me risk të lartë janë paraqitur në tabelën si në vijim:

## VLERËSIMET E RISKUT TË KRYERA NË INDUSTRITË MË RISK TË LARTË PËR 2021 DERI 2024



### Analiza dhe Rekomandime

- Rritja e Vetëdijësit:** Ka një përparim të dukshëm në vetëdijësimin e punëdhënësve dhe punëtorëve lidhur me rëndësinë e sigurisë dhe shëndetit në punë. Angazhimi i punëdhënësve për të ofruar trajnime dhe për të kryer vlerësime të riskut është një hap pozitiv drejt krijimit të një ambienti më të sigurt dhe më të shëndetshëm në vendin e punës.
- Përfshirja e Grave në Sigurinë dhe Shëndetin në Punë:** Statistikat tregojnë një rritje të përfshirjes së grave në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë. Megjithatë, është e rëndësishme të intensifikohen përpjekjet për të inkurajuar më shumë gra që të angazhohen si ekspertë dhe trajnues në këtë sektor, duke ofruar mundësi të barabarta për të dyja gjinitë.
- Çertifikimi dhe Licencimi i Kompanive dhe Ekspertëve:** Rritja e kërkesës për çertifikimin e ekspertëve dhe licencimin e kompanive të sigurisë dhe shëndetit në punë është një hap pozitiv, por gjithashtu është e rëndësishme që ky proces të vazhdojë të mbështetet me trajnime dhe burime për të siguruar një zbatim efikas të normave dhe rregullave të sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Trajnimet dhe Vlerësimet e Riskut:** Me rritjen e numrit të trajnimeve dhe vlerësimeve të riskut, është thelbësore që ky angazhim të vijojë dhe të përfshijë gjithashtu industritë që kanë nivele më të larta rreziku, si dhe të përmirësohet monitorimi i zbatimit të këtyre aktiviteteve për të garantuar se siguria dhe shëndeti në punë janë përparësitë kryesore të çdo kompanie.

### 7. KONTROLLET SHËNDETËSORE- ROLI I MJEKËSISË SË PUNËS

Kontrollet shëndetësore që punëdhënësit duhet ti kryejnë për punëtorët, janë një mjet i rëndësishëm për tu siguruar që punonjësit janë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre në mënyrë të sigurt dhe të shëndetshme, gjithashtu për të parandaluar rreziqet dhe për të zbuluar shenjat e mundshme të problemeve shëndetësore në fillim, duke mundësuar trajtimin e tyre në kohë dhe duke ndihmuar në ruajtjen e shëndetit dhe sigurisë së punëtorëve.

### **7.1. Numri i kontrolleve shëndetësore të siguruara nga shërbimet e specializuara të shëndetit (mjekësisë) së punës**

Kontrollet shëndetësore për punëtorët mbeten të pamjaftueshme. Mungesa e specialistëve të mjekësisë së punës është një pengesë kryesore për përmbushjen e kontrolleve sistematike shëndetësore. Një përpjekje për të rritur bashkëpunimin me institucionet shëndetësore po rezulton e suksesshme për disa institucione të Kosovës që kanë arritur Marrëveshje me Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë për dërgimin e punëtorëve në kontrollet sistematike shëndetësore dhe të njejtin shembull janë duke e vazhduar edhe Institucionet tjera këtë vit. Në kuadër të kontrolleve shëndetësore, MFPT dhe IP, kanë realizuar kontrollet sistematike për stafin e tyre

Si rrjedhojë, sipas raporteve që do ti paraqesim më poshtë të siguruara nga Institucionet e Mjekësisë së Punës (Qendra Kombëtare e Mjekësisë së Punës Gjakovë dhe Instituti i Mjekësisë së Punës Obiliq), vërehet një rritje e kontrolleve shëndetësore gjatë vitit 2024, krahasuar me dy vitet e mëparshme.

Në total, numri i shërbimeve të kryera gjatë vitit 2022, 2023 dhe 2024 nga institucionet e mjekësisë së punës, janë paraqitur në tabelën si në vijim:

<b>Kontrollet sistematike shëndetësore të punëtorëve</b>	<b>2022</b>	<b>2023</b>	<b>2024</b>
<b>Punëdhënës</b>	<b>43</b>	<b>30</b>	<b>49</b>
<b>Punëtorë të kontrolluar me vizita mjekësore</b>	<b>6267</b>	<b>6266</b>	<b>7063</b>

Sfidë kryesore gjatë shërbimeve që ofrohen nga këto institucione të mjekësisë së punës na paraqitet mungesa e specialistëve të mjekësisë së punës, duke pasur parasysh ndikimin që kanë në ofrimin e shërbimeve të sigurta dhe të shëndetshme për punëtorët. Përkundër këtyre sfidave, në fund të vitit 2024 në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë së Punës në Gjakovë, kanë përfunduar specializimin tre mjekët e parë të mjekësisë së punës.

Sfidë tjetër na paraqitet mungesa e një akti të plotë ligjor që rregullon organizimin dhe funksionimin e Mjekësisë së Punës, si dhe mungesa e një liste zyrtare për sëmundjet profesionale dhe regjistri kombëtar.

### **7.2. Rekomandim për Përmirësimin e Shërbimeve të Mjekësisë së Punës**

Për të siguruar kontrolle të rregullta dhe cilësore shëndetësore për punëtorët, rekomandohet investimi në specializimin e mjekëve të punës dhe mbështetja e specialistëve të rinj. Poashtu, është e nevojshme hartimi i një akti ligjor që rregullon funksionimin e Mjekësisë së Punës, krijimi i një liste zyrtare të sëmundjeve profesionale dhe një regjistri kombëtar.

Forcimi i bashkëpunimit mes institucioneve shëndetësore dhe punëdhënësve do të mundësojë kontrollë sistematike për punëtorët. Ndërkohë, monitorimi i cilësisë së

shërbimeve dhe përmirësimi i kapaciteteve teknike të qendrave të mjekësisë së punës do të siguroj një mbulim më të mirë dhe kushte më të sigurta pune.

## **8. SHPËRNDARJA E INFORMACIONEVE PËR SSHP**

Shpërndarja e informacioneve dhe aktiviteteve nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë, kryesisht bëhet nga akterët kyq të fushës dhe nga Organizatat Joqeveritare të cilat merren me këtë fushë.

Ministria e Financave, Punës dhe Transferëve në uebfaqen e re, portali puna, tek pjesa për SSHP, ka publikuar disa dokumente, si manuale, broshura, lista kontrolluese si dhe informacione tjera të rëndësishme nga kjo fushë<sup>4</sup>.

Gjatë punës empirike mbi përpilimin e analizës të gjendjes së sigurisë dhe shëndetit në punë, kemi parë se mediat elektronike kanë prekur shumë këtë fushë ku në shumë gazeta, televizione, portale e të tjera, kemi lajme të shumta mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Tematikat e tyre janë të ndryshme që nga aksidentet që ndodhin deri te intervistat me zyrtarët të cilët janë përgjegjës në zbatimin e ligjit mbi Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Shpërndarja e informacioneve, aktiviteteve dhe publikimeve në faqet e internetit bëhet nga organizatat e ndryshme dhe OJQ-të e ndryshme që merren me fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, siç është KOSHA, Qendra për politika dhe avokim (QPA), Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), pastaj publikime nga Oda Ekonomike e Kosovës (OEK), nga Kolegji Evropian i Kosovës etj.

## **9. ROLI I ORGANIZATAVE TË PUNËMARRËSVE DHE ORGANIZATAVE TË PUNËDHËNËSVE NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LEGJISLACIONIT PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË**

Përmes përgjigjeve të marra nga disa organizata të punëmarrësve (sindikatat), është konstatuar se shumica prej tyre nuk disponojnë mekanizma efektiv për të monitoruar përputhshmërinë e kushteve të punës me standardet e sigurisë dhe shëndetit në punë. Megjithatë, angazhimi i tyre kryesor është i përqendruar në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe përfaqësimin e tyre në përpjekjet për përmirësimin e kushteve të punës. Ky fokus ka kontribuar në ngritjen e ndërgjegjësimit për nevojën e përmirësimit të kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë, por ka hasur në disa vështirësi të theksuara.

### **9.1. Sfidat Kryesore të Organizatave të Punëmarrësve (Sindikatave)**

Një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballen sindikatat është mungesa e burimeve të mjaftueshme financiare dhe teknologjike për të realizuar një mbikëqyrje efektive të kushteve të punës. Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme, sindikatat shpesh ndihen të kufizuara në mundësitë për të siguruar trajnimet dhe mjetet e nevojshme për anëtarët e tyre, duke u përpjekur të mbrojnë të drejtat e punëtorëve. Gjithashtu, bashkëpunimi i pamjaftueshëm me punëdhënësit dhe institucionet për inspektime të efektshme është një pengesë tjetër që minon mundësitë për të siguruar kushte më të sigurta për punonjësit. Së fundi, një tjetër sfidë është mungesa e trajnimeve të rregullta për anëtarët sindikal, që është thelbësore për t'i

---

<sup>4</sup> <https://mfpt.rks-gov.net/Page/92>

mbajtur ata të përditësuar mbi legjislacionin dhe praktikat më të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë.

## **9.2. Sfidat e Organizatave të Punëdhënësve dhe Mungesa e Programeve të Rregullta për SSHP**

Nga diskutimet që janë zhvilluar në takimet me përfaqësues të Odës Ekonomike të Kosovës, është evidentuar se shumica e organizatave të punëdhënësve nuk kanë zhvilluar programe të rregullta për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë (SSHP). Një arsye kryesore për këtë është kostoja e lartë që lidhet me implementimin e këtyre programeve. Bizneset, për shkak të kufizimeve financiare, nuk janë në gjendje të mbulojnë shpenzimet që lidhen me zhvillimin e trajnimeve, inspektimet dhe masat e tjera të sigurisë. Pas këtij takimi, pyetësorët u dërguan disa organizatave të punëdhënësve, por fatkeqësisht asnjë nga këto organizata nuk ka ofruar përgjigje, që tregon një interes të pamjaftueshëm për të kontribuar në përmirësimin e kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë.

## **9.3. Tendenca e përmirësimit të Sigurisë dhe Shëndetit në Punë në Sektorin Privat**

Një element interesant i dalë nga hulumtimi i realizuar nga Oda Ekonomike e Kosovës, i cili është publikuar në raportin mbi “Sigurinë dhe Shëndetin në Punë në Sektorin Privat”, është lidhja mes numrit të punonjësve femra dhe njohurisë mbi kërkesat ligjore të SSHP-së. Analiza tregon se kompanitë që kanë më shumë femra të punësuar janë më të informuara dhe të angazhuara në përmbushjen e kërkesave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë. Rreth 67% e kompanive që punësojnë më shumë se 50 femra kanë njohuri të thella për kërkesat që duhet të plotësojnë për të siguruar kushte të sigurt për punonjësit e tyre. Në anën tjetër, asnjë kompani që nuk ka punësuar femra nuk ka theksuar këtë aspekt, që mund të sugjerojë një ndërlidhje midis pranisë së grave në sektorin e punës dhe përkushtimit për sigurinë dhe shëndetin në punë.

Në përgjithësi, situata aktuale për sigurinë dhe shëndetin në punë në Kosovë përballet me sfida të konsiderueshme, si nga ana e organizatave të punëmarrësve, ashtu edhe nga ajo e punëdhënësve. Oda Ekonomike e Kosovës, si organizata më e madhe e punëdhënësve, është licencuar si kompani për ofrimin e trajnimeve në këtë fushë, duke ofruar mundësi të mëdha për përmirësim.

**Rekomandim:** Përmirësimi mund të arrihet nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit ndërmjet palëve të interesuara, zhvillimit të trajnimeve dhe shpërndarjes së burimeve mbështetëse, si dhe përfshirjes aktive të sindikatave dhe punëdhënësve në zbatimin e kërkesave ligjore dhe praktikave më të mira për sigurinë dhe shëndetin në punë. Krijimi i një mjedisi të sigurt dhe të shëndetshëm në punë kërkon angazhim të vazhdueshëm dhe bashkëpunim të ngushtë ndërmjet të gjitha palëve të përfshira.

## **10. ANALIZA E INTEGRIMIT TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË (SSHP) NË PROGRAMET E STUDIMEVE TË FUSHAVE TEKNIKE NË KOSOVË**

Gjatë analizës dhe pranimit të pyetësorëve të plotësuar nga disa universitete të fushave teknike, është konstatuar se temat e sigurisë dhe shëndetit në punë nuk janë të përfshira në mënyrë të drejtpërdrejtë në kurrikulat e programeve të studimeve në nivelin e Bachelor-it në këto institucione. Kjo pasqyron një mangësi të rëndësishme në përgatitjen e studentëve për

të përballuar sfidat e sigurisë në punë në sektorët që kërkojnë njohuri të thella dhe aplikim të praktikave të sigurta në terren.

Një përjashtim nga ky trend është Fakulteti i Arkitekturës, ku në programin Master në *Eficiencën e Energjisë*, në Semestrin e III, është përfshirë lënda “Mbrojtja e Mjedisit, Shëndeti dhe Siguria në Punë”. Ky është një hap i rëndësishëm për përfshirjen e temave të sigurisë dhe shëndetit në punë në fushat teknike, sidomos në programet që lidhen me infrastrukturën dhe ndërtimin. Megjithatë, mungesa e një integrimi të tillë në shumicën e programeve të tjera teknike të nivelit Bachelor është një sfidë që kërkon vëmendje të menjëhershme.

Në vitin 2022, Rektorati i Universitetit të Prishtinës, në bashkëpunim me tri fakultetet teknike (Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike - FIEK, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit – FIN dhe Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike - FIM), ka nisur një iniciativë me synimin për zhvillimin e një programi të studimeve Master në “Sigurinë dhe Mjedisin në Punë”. Ky program, i cili është ende në proces zhvillimi dhe nuk është finalizuar, do të përfaqësonte një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një programi të specializuar që do të ofronte njohuri dhe aftësi të thelluara për menaxhimin e sigurisë dhe mjedisit në punë. Kjo iniciativë është një shembull i mirë i bashkëpunimit midis institucioneve akademike dhe nevojës për të integruar më shumë elementë të sigurisë dhe shëndetit në punë në arsimimin e lartë teknik.

Një nga sfidat më të mëdha që hasin këto institucione është mungesa e përfshirjes së sigurisë dhe shëndetit në punë në programet e studimeve Bachelor. Kjo është një mangësi e theksuar, pasi shumica e profesionistëve të fushave teknike, përfshirë inxhinierët dhe specialistët e tjerë, janë të përfshirë në projekte që kërkojnë njohuri të thella mbi sigurinë në punë. Pa një kurrikulë të specializuar, studentët mund të kenë vështirësi në përballimin e kërkesave të sigurisë dhe mund të krijohen hapësira për rreziqe të paplanifikuara gjatë aplikimit të njohurive në terren.

Gjithashtu, mungesa e trajnimeve praktike dhe eksperiencës në terren është një tjetër sfidë që ka ndikuar në përgatitjen e studentëve për të implementuar praktika të sigurta dhe të qëndrueshme në punë. Bashkëpunimi i kufizuar me industrinë për ofrimin e mundësive për eksperiencë praktike ka pamundësuar zhvillimin e aftësive të nevojshme në kushte reale të punës, të cilat janë të domosdoshme për një përgatitje të plotë profesionale.

### **Rekomandimet për përmirësim**

Për të adresuar këto sfida dhe për të përmirësuar situatën, janë të nevojshme disa hapa konkret. Përfshirja e temave të sigurisë dhe shëndetit në punë në të gjitha programet e studimeve të fushave teknike në nivelin Bachelor duhet të bëhet një prioritet. Kjo mund të realizohet përmes krijimit të moduleve dhe lëndëve të veçanta që do të mundësojnë zhvillimin e njohurive të nevojshme për menaxhimin e kushteve të sigurta të punës në industri të ndryshme.

Për më tepër, bashkëpunimi më i ngushtë midis universiteteve dhe sektorit industrial është i domosdoshëm për krijimin e mundësive për eksperiencë praktike dhe trajnimet e nevojshme për studentët. Ky bashkëpunim do të mundësojë që studentët të përvetësojnë praktikat më të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë në kontekste reale të punës dhe të kontribuojnë në ngritjen e nivelit të sigurisë në sektorin publik dhe privat.

Në përfundim, sfidat e identifikuara lidhur me mungesën e integritet të SSHP-së në kurrikulat e fushave teknike janë të rëndësishme dhe kërkojnë ndërhyrje urgjente. Përmirësimi i përfshirjes së temave të sigurisë dhe shëndetit në punë në arsimin teknik do të ndihmojë në zhvillimin e një brezi të ri profesionistësh të gatshëm për të përballuar sfidat e sigurisë në punë në mënyrë të efektshme dhe të qëndrueshme.

## **11. ANGAZHIMI I OJQ-VE DHE BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET PËR PROMOVIMIN E SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË (SSHP) NË KOSOVË**

Gjatë viteve të fundit, është vënë re një rritje e dukshme e bashkëpunimit midis institucioneve shtetërore dhe organizatave të shoqërisë civile (OJQ-ve) në promovimin e përbashkët të sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP). Ky bashkëpunim ka sjellë përmirësime në ndërgjegjësimin dhe zbatimin e masave të sigurisë në punë, duke ndihmuar në forcimin e politikave dhe praktikave për mbrojtjen e punëtorëve në Kosovë.

Një nga arritjet më të rëndësishme ka qenë **organizimi i aktiviteteve të përbashkëta** për promovimin e SSHP-së, përmes **kampanjave ndërgjegjësuere dhe organizimeve të ndryshme** që kanë pasur për qëllim angazhimin dhe informimin e punëtorëve dhe punëdhënësve mbi rëndësinë e sigurisë dhe shëndetit në punë. Këto aktivitete kanë përfshirë shpërndarjen e materialeve edukative, organizimin e trajnimeve dhe eventeve, si dhe realizimin e fushatave informuese për rreziqet që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë. Përmes këtyre organizimeve, është rritur ndërgjegjësimi i sektorëve të ndryshëm për rëndësinë e implementimit të standardeve të sigurisë në vendin e punës dhe është inkurajuar krijimi i kushteve më të sigurta për punëtorët.

Një tjetër zhvillim pozitiv ka qenë **zgjerimi i rolit të OJQ-ve në avokimin dhe lobimin për SSHP** në gjithë territorin e Kosovës. OJQ-të kanë luajtur një rol kyç në përhapjen e praktikave të mira dhe në ndikimin në politikat dhe ligjet për sigurinë dhe shëndetin në punë, duke siguruar që këto tema të jenë pjesë e diskutimeve dhe vendimmarrjes në nivel shtetëror. Ato kanë angazhuar punëtorët dhe punëdhënësit për të zbatuar më mirë ligjet dhe rregullat në fushën e SSHP-së dhe kanë nënvizuar rëndësinë e një mbikëqyrjeje më të fortë nga autoritetet për të parandaluar aksidentet dhe rrezikshmërinë në punë.

**Përfshirja e donatorëve** ka pasur gjithashtu një ndikim pozitiv, duke mundësuar mbështetje financiare dhe teknike për OJQ-të që punojnë në fushën e SSHP-së. Donatorët kanë ofruar mbështetje për **profilimin dhe forcimin e kapaciteteve** të OJQ-ve, duke kontribuar në zhvillimin e aktiviteteve të tyre dhe në rritjen e ndikimit të tyre në promovimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo mbështetje ka mundësuar që këto organizata të arrijnë një audiencë më të gjerë dhe të realizojnë projekte të rëndësishme për përmirësimin e kushteve të punës në Kosovë.

Bashkëpunimi ndërmjet institucioneve shtetërore dhe OJQ-ve, si dhe angazhimi i donatorëve, ka sjellë përmirësime të dukshme në promovimin e sigurisë dhe shëndetit në punë në Kosovë. Megjithatë, ende ekzistojnë sfida për t'u adresuar, siç është zhvillimi i fushatave të qëndrueshme informuese mbi rreziqet dhe masat mbrojtëse në vendin e punës, si dhe përfshirja e punëdhënësve dhe punëtorëve në trajnime të specializuara për standardet dhe rregulloret e sigurisë.

**Rekomandim:** Rritja e mbështetjes financiare dhe teknike për OJQ-të që veprojnë në fushën e sigurisë dhe shëndetit në Punë (SSHP), si dhe përmirësimi i kapaciteteve të tyre për avokim dhe lobim efektiv në zhvillimin e politikave dhe legjislacionit të SSHP. Gjithashtu, është e rëndësishme të forcohet bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare, në mënyrë që të ndjekin praktikat më të mira globale në këtë fushë, duke siguruar angazhim të vazhdueshëm dhe mbështetje të fortë nga të gjitha palët e interesuara.

## **12. SFIDAT KRYESORE TË SISTEMIT TË SIGURISË DHE SHËNDETIT NË PUNË**

Në Kosovë, aksidentet në punë, sidomos në sektorin e ndërtimit dhe industrisë së prodhimit, janë mjaft të zakonshme. Sipas statistikave të fundit, numri i aksidenteve në vendin e punës është në rënie, por sfida kryesore mbetet mbulimi i shpenzimeve të hospitalizimit, rehabilitimit, zëvendësimit të punëtorëve dhe humbjes së produktivitetit të kompanisë ose ndërmarrjes. Shkaqet kryesore të aksidenteve përfshijnë mungesën e pajisjeve mbrojtëse, trajnimin e pamjaftueshëm të punonjësve dhe shkeljen e rregullave të sigurisë.

Sektorët më të rrezikuar si ndërtimtaria, energjia, minierat dhe industria përpunuese përbëjnë sektorët me shkallën më të lartë të aksidenteve në punë. Këta sektorë shpesh karakterizohen nga mungesa e masave të duhura mbrojtëse dhe nga kushtet e rënda të punës që rrisin rrezikun për punëtorët.

Edhe pse sipas të dhënave nga Kompanitë e licencuara për shërbime, viteve të fundit numri i vlerësimeve të riskut nëpër kompani është rritur, ende ka shumë kompani që nuk e kanë përfunduar vlerësimin e riskut.

Edukimi, ndërgjegjësimi dhe trajnimi për sigurinë dhe shëndetin në punë janë të pamjaftueshme, sidomos për punonjësit e rinj ose ata që punojnë në industri me rrezik të lartë. Investimi në edukimin, trajnimin dhe fushatat informuese për sigurinë, si dhe promovimi i një kulture të fortë të sigurisë, janë thelbësore për të arritur një ambient pune të sigurt dhe të shëndetshëm, e cila do të ndikonte pozitivisht në uljen e aksidenteve dhe rrezikut për shëndetin e punonjësve.

Shumë punëdhënës nuk investojnë në masat parandaluese, si trajnime për sigurinë apo pajisje mbrojtëse për punonjësit. Në të njëjtën kohë, punëtorët nuk janë gjithmonë të ndërgjegjshëm për rreziqet dhe për rëndësinë e respektimit të masave mbrojtëse.

Kostoja e lartë për infrastrukturë dhe trajnim si dhe mungesa e programeve të rregullta për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, mbeten pengesa kryesore për bizneset në përmbushjen e kushteve të sigurisë dhe shëndetit në punë (SSHP).

Organizatat e punëmarrësve si përfaqësues të punëtorëve, nuk kanë programe të rregullta për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe në përgjithësi angazhimi i tyre fokusohet në **mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve** dhe përfaqësimin e tyre për përmirësimin e kushteve të punës.

Mungesa e analizave vjetore të sëmundjeve profesionale dhe aksidenteve në punë, mungesa e një regjistri kombëtar për to, mungesa e specialistëve të mjekësisë së punës dhe mosfunksionimi i Këshillit Nacional për Siguri dhe Shëndet në Punë, mbeten sfida për vendin.

Sa i përket zbatimit të ligjit në praktikë, sipas një hulumtimi të kryer në vitin 2021 nga Oda Ekonomike thuhet: “Me qëllim të krijimit të një pasqyre të qartë rreth sigurisë dhe shëndetit

në punë, në këtë hulumtim janë identifikuar sfidat kryesore me të cilat janë përballur më së shumti kompanitë”:

Rreth gjysma e bizneseve të anketuara kanë theksuar se si pengesë kryesore për zbatimin e ligjit për siguri dhe shëndet në punë është kostoja e lartë e infrastrukturës së kërkuar për t'i përmbushur kushtet për siguri dhe shëndet (49%), si pengesë e dytë më e raportuar nga kompanitë është kostoja e lartë e trajnimit të punëtorëve (46%), pasuar nga kërkesat e larta dhe të papërballueshme për infrastrukturë (43%), duke vazhduar me vështirësitë që kompanitë hasin për mbulimin e të gjitha shpenzimeve për kurimin e të punësuarve të cilët kanë pësuar lëndime në punë apo sëmundje të ndryshme gjatë procesit të punës (40%). Mosbindja e kërkesave dhe udhëzimeve të punëdhënësve nga ana e punëtorëve (30%), kostoja e lartë për të dëshmuar kushtet e punës (28%), si dhe vështirësitë në pajisjen e punëtorëve me mjetet profesionale të punës dhe aparaturat matëse adekuate (14.18%) raportohen po ashtu të jenë pengesa të shfaqura gjatë zbatimit të ligjit për sigurinë dhe shëndetin në vendin e punës por në një shkallë më të ulët.”<sup>5</sup>

### **13. REKOMANDIMET:**

#### **1. Përmirësimi i Legjislacionit dhe Zbatimit**

- Ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit nr. 04/L-161 për SSHP, duke siguruar transpozimin e plotë të Direktivës Kornizë 89/391/EC të BE-së,
- Miratimi dhe zbatimi i rregulloreve të mbetura për një mjedis pune më të sigurt dhe të shëndetshëm.
- Implementimi i standardeve ndërkombëtare, si ISO 45001, në të gjitha bizneset, përfshirë edhe bizneset e vogla.

#### **2. Forcimi i Kapaciteteve Institucionale**

- Rritja e burimeve dhe trajnimeve për Inspektoratin e Punës. për të forcuar aftësitë inspektuese.
- Ri-themelimi i Këshillit Nacional për SSHP dhe rikthimi i rolit të tij këshillues.
- Forcimi i bashkëpunimit me institucione tjera për inspektime më efektive dhe për të siguruar zbatimin e standardeve të SSHP-së.

#### **3. Monitorimi dhe Raportimi i Aksidenteve dhe Sëmundjeve Profesionale**

- Krijimi i regjistrit kombëtar të aksidenteve në punë dhe analizave vjetore.
- Vetëdijësimi i punëdhënësve për regjistrimin e aksidenteve sipas sistemit ESAË.
- Hartimi dhe zbatimi i një liste kombëtare të sëmundjeve profesionale, duke mundësuar trajtimin dhe diagnostikimin e sëmundjeve të lidhura me punën.
- Funkcionalizimi dhe akreditimi i laboratorëve në Institucionet e mjekësisë së punës për diagnozën e sëmundjeve profesionale.

---

<sup>5</sup> Oda Ekonomike e Kosovës, “Siguria dhe Shëndeti në Punë në Sektorin Privat të Kosovës”, Prishtinë, 2021.

#### **4. Investimi në Sigurinë dhe Shëndetin në Punë**

- Hapja e specializimeve për mjekësi të punës dhe rregullimi i statusit të Institutit të Mjekësisë së Punës në Obiliq.
- Përmirësimi i kushteve të punës me teknologji dhe pajisje të standardizuara sigurie.
- Investimi në staf dhe pajisje moderne për rritjen e efikasitetit dhe sigurisë.

#### **5. Edukimi, Trajnimi dhe Ndërgjegjësimi**

- Organizimi i trajnimeve dhe fushatave për SSHP për punëtorët dhe punëdhënësit.
- Përfshirja e moduleve për menaxhimin e stresit në trajnimet e SSHP-së.
- Fushata publike dhe informuese mbi rëndësinë e SSHP-së.
- Edukimi i vazhdueshëm i punëdhënësve dhe punonjësve përmes trajnimeve të specializuara.
- Zhvillimi i trajnimeve për sindikatat për njohuritë mbi të drejtat dhe obligimet lidhur me SSHP.
- Integrimi i sigurisë dhe shëndetit në punë në nivelin bachelor të arsimit tekniko-profesional dhe krijimi i moduleve të detajuara mbi këtë fushë.
- Bashkëpunimi me industrinë për trajnime praktike dhe vizita studimore për përgatitjen e profesionistëve të rinj.

#### **6. Mbështetja dhe Kompensimi për Punonjësit e Aksidentuar**

- Ofrimi i asistencës teknike për rastet e punëmarrësve/eve të cilët aksidentohen në vendin e punës, dhe që kompensimin e kërkojnë përmes padisë civile, në mënyrë që të gjithë të aksidentuarit në vende të punës të kompensohen për dëmin e shkaktuar.”<sup>6</sup>
- Rritja e transparencës dhe përfshirja e punëtorëve në raportimin e kushteve të pasigurta në punë.

### **Përfundim**

Siguria dhe shëndeti në punë në Kosovë përbën një sfidë kryesore të vazhdueshme që kërkon përmirësime në zbatim, ndërgjegjësim dhe investim. Një qasje gjithëpërfshirëse nga institucionet publike, sektori privat, organizatat e punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe shoqëria civile është thelbësore për të krijuar një mjedis pune të sigurt dhe të shëndetshëm, duke kontribuar në mirëqenien dhe produktivitetin e punëtorëve.

---

<sup>6</sup> Qendra për Politika dhe Avokim: “Fondi i Sigurimeve Shoqërore: Kompenzimi i aksidenteve në vend të punës”, Prishtinë, Nëntor, 2021.

## ANEKS

Në tabelën më poshtë janë paraqitur pyetësorët që janë dërguar tek grupet e interesit.

Me "Po" dhe "Jo" janë shënuar organizatat ose institucionet që janë përgjigjur, përkatësisht ato që nuk janë përgjigjur në plotësimin e pyetësorëve.

Pyetësorët:	Komentet e pranuar/ Komentet e papranuara	
	Po	Jo
1. Pyetësor për Inspektoratin e Punës	Po	
2. Pyetësor për Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë		Jo
3. Pyetësor për Ministrinë e Shëndetësisë		Jo
4. Pyetësor për Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale	Po	
5. Pyetësor për Agjencinë për mbrojtje rrezatimi dhe siguri bërthamore		Jo
6. Pyetësor për ekspertët dhe shërbimet e sigurisë dhe shëndetit në punë	Po	
7. Pyetësor për Institutet e Mjekësisë së Punës	Po	
8. Pyetësor për Universitetet e fushave teknike	Po	
9. Pyetësor për Universitetet e shkencave natyrore		Jo
10. Pyetësor për organizatat e punëmarrësve (Sindikatat)	Po	
11. Pyetësor për organizatat e punëdhënësve		Jo
12. Pyetësor për Organizatat e shoqërisë civile	Po	

Më poshtë janë disa nga publikimet që janë analizuar gjatë hartimit të analizës:

1. Faqja e internetit të MFPT-së, <https://mfpt.rks-gov.net/Puna/Page/306>
2. Raporti vjetor i punës së Inspektoratit të Punës për vitin 2022: [Reports - Labour Inspectorate \(rks-gov.net\)](https://rks-gov.net/Reports-Labour-Inspectorate)
3. Raporti vjetor i punës së Inspektoratit të Punës për vitin 2023: [https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/IQP\\_RaportiVjetor-2023-Shqip.pdf](https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/IQP_RaportiVjetor-2023-Shqip.pdf);
4. Raporti vjetor i punës së Inspektoratit të Punës për vitin 2024: [https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/RaportiVjetor\\_2024\\_InspektoratitPunes.pdf](https://ip.rks-gov.net/ep-content/uploads/RaportiVjetor_2024_InspektoratitPunes.pdf);
5. Oda Ekonomike e Kosovës, e cila ka publikuar punimin me titullin: “Siguria dhe Shëndeti në Punë në Sektorin Privat të Kosovës” etj.
6. Iniciativa Kosovare për Stabilitet (IKS), e cila ka publikuar hulumtimin me titullin: “Raporti i monitorimit të Ligjit të Punës në Kosovë”  
<https://iksëeb.org/ep-content/uploads/2022/01/Microsoft-Ëord-Monitorimi-i-bizneseve-Final.docx.pdf>
7. Qendra për Politika dhe Avokim, e cila ka publikuar punimin me titullin:  
“Kompenzimi i Aksidenteve në vendin e punës”;
8. Organizata KOSHA e cila permban shume lajme dhe informacione rreth sigurise dhe shendetit ne pune duke filluar nga aksidentet, vdekjet, promovim te drejtave te punetoreve, mirenjohje e ndara ne kete fushe etj.  
<https://ëëë.facebook.com/people/KOSHA/100064738207379/>
9. Publikimi nga: Kolegji Evropian i Kosoves, 10 Arsyet - Pse siguria në vendin e punës është e rëndësishme?
10. Publikimi nga: Telegrafi, 11 vdekje dhe 330 aksidente në vendin e punës gjatë vitit 2023.  
<https://telegrafi.com/11-vdekje-dhe-330-aksidente-ne-vendin-e-punes-gjate-vitit-2023/>
11. Publikimi nga: Kallxo.com, Siguria dhe shëndeti në punë, obligimet e punëdhënësit dhe të punësuarit. <https://kallxo.com/gjate/analize/siguria-dhe-shendetit-ne-pune-obligimet-e-punedhenesit-dhe-te-punesuarit/>